

Informatat për ndarje dhe shkurorëzim në martesë, partneritet të regjistruar dhe konkubinë

Unë dua të ndahem: Sie duhet të veprojt?

Ju mundeni pranë Gjykatës së Kantonit të Glarus-it ta filloni (iniconi) procesin për mbrojtjen e martesës dhe mund të parashtoni (paraqitni) kërkesë për të jetuar ndaras. Atëherë ju nuk jeni i/e shkurorëzuar, por të ndarë me vendim gjykate (me ligj). Shkurorëzimi në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet partnerëve është i mundur jo më herët se dy vite jetese ndaras. Ju mund ta shtroni vetë kërkesën për ndarje me anë të formularit „procesi për mbrojtjen e martesës“ apo ta iniconi përmes Avokatit. Zyra për Mbrojtjen e Viktimave ju ndihmon me dëshirë.

Ne ju rekomandojmë që në bisedën (kontaktin) e parë pranë gjykatës apo te Avokati ti merrni me vete dokumentet pasuese:

- ✓ dy deklaratimet e fundit të tatimit
- ✓ klasifikimin e fundit tatimor
- ✓ përlogaritjet e pagave të gjashtë muajve të fundit
- ✓ listat e kontove të gjashtë muajve të fundit (Post- und Bankkonto)
- ✓ Dokumentet me të dhënat për ushtrimin e dhunës në partneritet (raportet mjekësore, aktet e procesit, vendimet për masat mbrojtëse)

Kush e paguan procesin për mbrojtjen e martesës dhe/ose avokatin?

Në qoftë se keni pak para parashtoni kërkesën (aplikoni) për **ndihmë juridike falas**. Në qoftë se kërkesa e juaj miratohet do të hiqen shpenzimet e gjykatës së dhe shpenzimet e avokatit dhe të përkthimit. Më së voni mbas pesë viteve arka e gjykatës do të verifikojë se a keni mundësi për ti kthyer shpenzimet. Në rast nevojë do të arrihet marrëveshje për kthimin e borxhit apo do të lëshohet një marrëveshje për pranimin e borxhit. Me një marrëveshje të tillë automatikisht do të ndërprehet afati 10 vjeçarë i vjetërsimit. Ju gjithashtu vetë mundeni të merreni vesh me avokatin për kthimin e borxhit në qoftë se keni mundësi t'i paguani shpenzimet e avokatit.

Çka rregullohet me procesin e mbrojtjes së martesës?

- ✓ Kujt i lejohet të qëndroj në banesë. Ky është personi i cili ka më shumë nevojë për banesën; kryesisht personi, i cili shumicën e kohës përkujdeset për fëmijët. Aplikoni për terminin për lëshimin e banesës dhe dorëzimin e të gjithë çelësave të banesës, në qoftë se dëshironi të qëndroni në banesë.
- ✓ Ku do të banojnë fëmijët (shumicën e kohës).
- ✓ Se si prindërit do ta rregullojnë përkujdesin ndaj fëmijëve.
- ✓ Se sa shpenzime jetësore do të paguaj personi i detyruar të paguaj për shpenzimet e fëmijëve (alimentacion). Deri në moshën 18. vjeçare apo deri te kryerja e arsimimit të parë, fëmijët gëzojnë të drejtën për alimentacion. Në qoftë personi i cili sipas vendimit gjyqësorë është i detyruar të paguaj shpenzime nuk e paguan alimentacionin, mund të aktivizohet vetë për ti nxjerrë borxhet. Apo ju mund ta shfrytëzoni të drejtën e mbështetjes nga Zyra Shtetërore e Alimentacionit.

Si rrjedh procesi i mbrojtjes së martesës?

- ✓ Ju e parashtroni (paraqitni) kërkesën juridike për mbrojtjen e martesës (Ndarja).
- ✓ Ju e arsyetoni me gojë ankesën tuaj dhe i paraqitni dëshmitë.
- ✓ Pala e kundërt gjithashtu mund të paraqes kërkesa.
- ✓ Gjykata kërkon nga pala e kundërt arsyetimin me gojë dhe i ipet mundësia të shprehet në lidhje me kërkesën tuaj juridike.
- ✓ Në rrethana të caktuara do të ketë marrje në pyetje nga gjykata.
- ✓ Nganjëherë gjykata kërkon që aktet e tjera të dorëzohen më vonë.

Frika ndaj veprimit të dhunshëm për shkak të ndarjes

Në qoftë se personi i lënë ju kërcënon ju dhe fëmijët tuaj apo ai ushtron dhunë, atëherë policia menjëherë mund ta kryej dëbimin. Ju mund ta vazhdoni dëbimin, brenda 5 ditëve pas dëbimit edhe për 10 ditë tjera. Në qoftë se ju edhe më tej keni frikë se mund të kërcënoheni, mund të aplikoni për masa tjera mbrojtëse pranë gjykatës civile (dëbim, ndalimi i kontaktit dhe vendit të caktuar). Ne ju mbështesim dhe këshillojmë për kërkesat e tilla me ruajtje të fshehtësisë dhe papagesë. Nëse ekziston rreziku i lartë dhe personi i lënë nuk ju përmbahet ndalesave, ne mundemi ju dhe fëmijët tuaj t'ju akomodojmë në një strehim të mbrojtur.

Nëse kërkohet të reagohet shpejtë?

Në qoftë se ju i dëshmoni veprimet e dhunshme dhe me këtë mund ta dëshmoni rrezikun (urgjencën) e veprimit, mundeni të aplikoni pranë gjykatës për të ashtuquajturat «masa super-provizore». Atëherë gjykata i rregullon menjëherë çështjet më të rëndësishme të procesit për mbrojtjen e martesës, pa i dëgjuar palët.

Te kush do të jetojnë fëmijët dhe si rregullohet përkujdesi i mëtutjeshëm?

Fëmijët do të duhej të jetonin te ai prind i cili deri më tani kryesisht është përkujdesur ndaj fëmijëve dhe i cili edhe më tej mund ta garantoj atë. Në rend të parë qëndron mirëqenja e fëmijëve dhe gjykata mundet t'i marr në pyetje personalisht fëmijët nga mosha 6 vjeçare. Të dy prindërit e kanë të drejtën e kontaktit me fëmijët. Për këtë arsye rekomandohet marrëveshje për përkujdesin dhe të drejtën e vizitës. Në qoftë se fëmijët kërcënohen ose gjatë vizitave vie deri te konfrontimet e dhunshme mundeni të aplikoni për të drejtën e vizitës në shoqërim ose për kujdestari.

Me çka (si) të jetojmë?

Mud të shkojë shumë gjatë deri sa vendimi i plotëfuqishëm i gjykatës për shpenzimet jetësore të jetë në dispozicion dhe ju të mund t'i merrni Alimentet. Për këtë arsye aplikoni paraprakisht për ndihmë financiare sociale pranë shërbimeve sociale të Kantonit të Glarus-it. Në qoftë se ju e keni një konto të përbashkët me personin i cili ushtron dhunë dhe ju vetë nuk keni kursime vetanake, atëherë tërhiqni ca para, përafërsisht për dy muaj, dhe bllokoni të drejtën e çasjes në konto të personit tjetër. Ju rekomandohet ta hapni një konto tjetër në emrin tuaj. Në procesin e mbrojtjes familjare përllogaritet nevoja financiare e të dy familjeve dhe zbritet nga të ardhurat përkatëse. Kjo e ndërton bazën mbi të cilën përllogariten alimentacionet. Në qoftë se alimentacioni dhe të ardhurat nga puna nuk mjaftojnë për shpenzimet jetësore, atëherë si shtesë ju nevojitet ndihma sociale. Nëse e keni në dispozicion vendimin e vlefshëm për mbrojtjen e martesës dhe dëshironi të punoni mundeni të aplikoni te sigurimi i të papunësuarve për 90 mëditje (pagesa ditore) apo paradhënien e alimentacionit pranë Kantonit të Glarus-it.

Unë jam një person i huaj – a ka ndarja ndikim ndaj titullit (lejes) të qëndrimit tim?

Shumë nga gratë e prekura e kanë statusin e lejes së qëndrimit B (B-Aufenthaltsstatus), sepse ato në Zvicër kanë ardhur përmes bashkimit familjar; ashtu që leja e qëndrimit është e kushtëzuar me bashkëjetesën. Personat nga vendet e EU-s kanë parakushte më të mira për të qëndruar në Zvicër. Personat të cilët nuk janë nga EU, në rast të ndarjes, mund të aplikojnë pranë Entit për Migracion (Migrationsamt) për vazhdimin e lejes së qëndrimit, në qoftë se në Zvicër kanë jetuar më së paku tre vite dhe mund ta dëshmojnë integrimin. Ju mund t'i paraqitni arsyet personale (viktimë e dhunës në familje ose rrezikimin e riintegritimit në atëdhe). Në lidhje me këtë ju këshillojmë me ruajtje të fshehtësisë dhe pa shpenzime.

Çka ndodhë në një seancë për mbrojtjen e martesës?

Ju nuk mundeni t'i merrni fëmijët me vete. Për këtë arsye organizoni përkujdesin për fëmijë të paktën një gjysmë dite. Kërkoni me kohë një përkthyes për seancën në qoftë se gjermanishtja nuk është gjuha e juaj amëtare. Në qoftë se ju përfaqësoheni nga avokati, atëherë avokati juaj do t'iu njoftoj në lidhje me procedurën. Në qoftë se ju para gjykatës paraqiteni pa shoqërimin e avokatit, atëherë mos nënshkruani kurrëfarë marrëveshje në qoftë se jeni e pasigurtë. Nënshkruani vetëm atëherë nëse ju mundësohet e drejta e tërheqjes në afatin prej 10 ditëve. Ju mundeni rregullatë afatit të tërheqjes të konsultoheni lidhur me marrëveshjen me specialistin.

Çkq mund të ndërmarrë kundër vendimit të gjykatës, në qoftë se nuk pajtohem me te?

Ju duhet ta kërkoni vendimin e arsyetuar mbrenda afatit prej 10 ditëve apo ta apeloni atë. Këshillat Juridike i gjeni në fund të vendimit gjyqësor. Mbasi të kalojnë 10 ditë ndryshimi është i mundur vetëm në rast të ndryshimeve të konsiderueshme të gjendjes jetësore. Nëse ju përsëri dëshironi të jetoni bashkë me palën tjetër vendimi gjyqësor bie poshtë (nuk vlenë më).

A nuk është shkurorëzimi më i mirë se mbrojtja e martesës?

Shkurorëzimi është i mundur në çdo kohë në qoftë se të dy palët pajtohen me te. Këtë vullnet mund ta përforconi në një marrëveshje të përbashkët, e cila megjithatë mund të tërhiqet. Kundër vullnetit të palës tjetër shkurorëzimi mund të realizohet vetëm dy viteve pas ndarjes. Procesi i mbrojtjes së martesës parimisht është shumë më i shpejtë.

Çka mund të bëj në qoftë se jam e/i detyruar të martohem me shtrëngim?

«Martesa e detyruar» është e ndaluar në Zvicër. Në këtë rast nuk luan rol se ku është kryer martesa, në Zvicër apo jashtë vendit. Në Zvicër ju keni të drejtë lirisht ta zgjedhni partnerin apo partnerin tuaj. Ne ju këshillojmë në pyetjet për martesën e detyruar anonim (me ruajtje të fshehtësisë) dhe pa shpenzime.

Si mund ta zgjidhë një partneritet të regjistruar?

Ju mund ta iniconi ndarjen pranë Gjykatës Kantonale të Glarus-it dhe në rast kërcënimi apo dhune mund të aplikoni për masa mbrojtëse analogjikisht me procesin e mbrojtjes së martesës. Në qoftë se ju nuk mund të merreni vesh për zgjidhjen me palën tjetër, atëherë ju mund ta zgjidhni partneritetin kundër vullnetit të sajë mbas një viti.

Ne jetojmë në Konkubinë – si mund të ndahem?

Në rastin e ndarjes së konkubinës zhvillohen njëkohësisht disa procedura. Autoriteti për mbrojtjen e fëmijut dhe të të rriturve e rregullon caktimin e kujdestarisë dhe përkujdesit. Gjykata Kantonale e rregullon alimentacionin. Kujt i lejohet qëndrimi në banesë varet nga një anë nga nënshkrimet në kontratën e qirasë, nga vullneti i mirë i qeradhënësit dhe nga pala tjetër. Në rast dhune, ju si person i prekur, edhe në konkubinë mund të parashtroni (paraqitni) kërkesë pranë gjykatës civile Ne ju këshillojmë për këtë pa shpenzime dhe me ruajtje të fshehtësisë (anonimitet).

Adresa të dobishme:

- Glarner Anwaltsverband (**Shoqata e Avokatëve të Glarus-it**): <http://www.glav.ch/>
- Anwaltsregister Kanton Glarus (**Regjistri i avokatëve Kantoni i Glarus-it**): <https://www.gl.ch/rechtspflege/anwaltsregister.html/276>
- Gesuch unentgeltliche Rechtspflege Kanton Glarus (**Kërkesa për Ndhim Juridike falas**): https://www.gl.ch/public/upload/assets/7652/18_Gesuch_unentgeltliche_Rechtspflege.pdf
- Gesuch Eheschutz Kanton Glarus (Trennung) (**Aplikacioni Mbrojtja e Martesës Kantoni i Glarus-it (Ndarja)**) <https://www.gl.ch/rechtspflege/online-schalter.html/287>

Si bazë për shkrimin e këtij fletëudhëzimi kanë shërbyer informatat juridike të Web-faqes së BIF qendra e këshillave për gratë e martuara dhe partneritet për ndarjen dhe shkurorëzimin.